



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

Nr Regj. 6.10326/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE- PEJË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Fehmi Geci nga Klina, për shkak të kundërvajtjes nga neni 6 par. 1 lidhur me nenin 16 par 1, pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, në bazë të nenit 37, 123 e 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 21.11.2011 merr këtë :

A K T V E N D I M

1.I pandehuri **FEHMI /SHEREMET/ GECI**, i lindur me dt.31.12.1963 në fshatin Llaushë, KK Skënderaj, me banim në Klinë, Rr.'Dëshmorët e Kombit', P.N., me profesion Drejtor në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Kosovës,

Është përgjegjës.

-Sepse deri me dt. 31.03.2011, si Zyrtar i Lartë Publik, nuk e ka deklaruar pasurin, në atë mënyrë që si Drejtor i Institutit Bujqësor të Kosovës në Pejë edhe pse i informuar me kohë nga ana e Agjensionit Kundër Korrupsion, ka lëshuar afatin Ligjor për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2011.

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par. 2 lidhur me nenin 16 par 1, pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik

Andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore

D E N O H E T

ME DENIM NË TË HOLLA në shumë prej **500(pesëqind) €**,

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e në të kundërtën ky dënim do t i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh,

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **5 (pesë)€**, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimi.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet palëve

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA		AGJENCIA PËR LUTJËN KËRKIMORË AGENCIJA PROTIV KORUPCION ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	D-P	Nr. Prot.	03-4594/11
Dep.		Prot. No.	
Nr.faq	01	Data	24.11.2011
Isroj. stranca		Data	
Nr. pages		Data	
PUSH DNE			

Arsyetim

Agjensioni Kundër Korrupsion në Prishtinë, ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-3189/11, të dt.14.07.2011, kundër të pandehurit, me shënime si në dispozitiv, duke kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike, filloi procedurën kundërvajtëse, me ç'rast dëgjoi të pandehurin, i cili lidhur me Kërkesën në fjalë deklaroi se është e vërtetë që si zyrtar i lartë, nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin 2011 edhe pse ka qenë në dijeni për obligimin, nga se ka qenë shumë i ngarkuar me punë. E ndien veten përgjegjës dhe se do t'i bindet çdo vendimi që do të merr Gjykata.

Duke pas parasysh se pranimitë e fajësisë nga ana e të pandehurit, është në përputhje të plotë me prova tjera materiale në shkresat e lëndës, Gjykata nuk e pa të arsyeshme që të mbledhë prova shtesë në këtë çështje.

Me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, Gjykata si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimitë e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe sjelljen korrekte në gjykatë, si dhe rrethanat tjera të parapara me nenin 7 të LK, në bazë të të cilave edhe iu shqiptua dënimi i theksuar më lartë, me bindje se edhe ky dënim do të ndikojë që i pandehuri në të ardhmen të mos përsërisë kundërvajtje të tilla, apo të ngjashme.

**Vendosur në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Pejë
Nr Regj. 6-10326/11, dt .21.11.2011**

**Gjyqtari
Feti Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i Kërkesës dhe i pandehuri kanë të drejtë **Ankese**, në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtjet në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate, në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi